



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:147355  
Datë: 13.08.2024  
Numri i dokumentit: 06046337

**C.nr.5286/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Florian Krasniqi në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.M. të cilin e përfaqëson Xh. K., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës E. Sh.p.k të cilën e përfaqëson avokat A.F., me adresë në Rr. B. i D. të K., D.-II-8-1, U., Prishtinë, me objekt kontesti: pagesën e të ardhurave personale, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik, me datë 13.08.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. REFUZOHET** në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit I.M. ndaj të paditurës E. Sh.p.k, përmes të cilës ka kërkuar që të obligohet e paditura që në emër të diferencës së pagave të papaguara, për periudhën kohore nga data 01.08.2021 e deri me datë 21.02.2023, t'ia paguajë paditësit shumat si në vijim: në emër të diferencës së pagave neto, shumën prej 835.16 euro, në emër të kontributit pensional shumën prej 97.00 euro dhe në emër të tatimit në të ardhura personale shumën prej 92.8 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në vit nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive.
- II. DETYROHET** paditësi I.M. që të paditurës E. Sh.p.k në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, t'ia paguajë shumën prej 374.00 euro brenda afatit prej shtatë ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësi përmes të autorizuarit të tij pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi ndaj të paditurës me objekt kontesti pagesën e të ardhurave personale. Në padi ndër të tjera ka deklaruar se, paditësi ka punuar që nga vitit 1986 në shtëpinë e shëndetit në Prishtinë – shërbimi stomatologjik, dhe po ashtu ka vazhduar të punoj edhe pas datës 01.12.2010 kur shërbimin e pastruesve e ka marr nën menaxhim e paditura. Ka theksuar se paditësi vazhdon të punoj tek e paditura por që e paditura që nga data 15.02.2021 paditësit nuk i ka paguar pagën e as kontributet që parashihen me ligj. Tutje ka theksuar se, paditësi ka paraqitur ankesë tek e paditura për pagesën e këtyre pagave por që nga e njëjta nuk ka marrë asnjë përgjigje. Në seanca të shqyrtimit gjyqësor, përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se, paditësi punët dhe detyrat e punës i ka kryer me përkushtim maksimal dhe nëse e paditura ka pasur vërejtje lidhur me punën e paditësit ka

pasur mundësinë që të themelojë komision disiplinor e në përbërje të të cilit duhet të jetë edhe një anëtar i sindikatës. Tutje ka theksuar se e paditura ka pasur mundësi që paditësit fillimisht ti shqiptojë një masë qortimi, pastaj zvogëlimin e pagës prej 50%, 6 muaj periudhë të para përjashtimit dhe në fund ndërprerja e marrëdhënies së punës. Tutje në fjalën përfundimtare ka theksuar se e paditura paditësit ia ka ndërprerë pagesën e pagave nga data 01.08.2021 e deri në pensionimin e tij me datë 21.02.2023 edhe pse paditësi për këtë periudhë rregullisht ka punuar. Ka theksuar se paditësi për shkeljet ligjore nga e paditura ka paraqitur ankesë edhe në inspektoratin e punës, ku inspektorati i punës ka gjetur shkelje ligjore nga e paditura sipas ankesës së paraqitur nga paditësi. Ka theksuar se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditësit nuk i është dorëzuar asnjëherë dhe as provat e dorëzuara nga përfaqësuesi i të paditurës nuk e argumentojnë një fakt të tillë, ngase nga dorëzuesi është shënuar se adresa është e pa njohur. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i specifikuar.

E paditura me përgjigje në padi ka theksuar se, nuk i konteston Kontratat e punës që e paditura i ka pasur me paditësin, por që e paditura i ka paguar të gjitha pagat paditësit deri në kohën e përfundimit të afatit të Kontratës së punës me paditësin sipas transfereve bankare në shkresat e lëndës. Ka theksuar Kontrata e punës ka qenë me kohë të caktuar dhe paditësi që nga momenti i nënshkrimit të Kontratës ka qenë i njoftuar për periudhën e vlefshmërisë së Kontratës, dhe se sipas nenit 65 të Ligjit të Punës Kontrata e punës ndërpritet me skadimin e kohëzgjatjes së saj. Në seanca gjyqësore përfaqësuesi i paditësit ka theksuar se paditësit i është ndërprerë Kontrata e punës dhe janë paguar të gjitha pagat, duke përfshirë edhe pagesën prej 30 ditëve për shkak të mos njoftimit për ndërprerje të Kontratës së punës. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

Gjykata ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe me propozimin e palëve ndërgjyqëse ka administruar provat si në vijim: Kontrata e punës e datës 26.12.2020, ankesa e datës 06.05.2021, pagesa për muajin 05/21, pagesa për muajin 04/21, pagesa për muajin 07/21, pagesa për muajin 06/21, vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës i datës 30.07.2021, vërejtje e datës 13.09.2019, vërejtje e datës 26.01.2021, ekspertiza financiare e datës 03.06.2024, ankesa e datës 09.02.2018, ankesa e datës 01.04.2020, kërkesa e datës 07.04.2021, raport zyrtar me numër 01.nr.09-39-1117/2021 i datës 21.07.2021, vendimi me numër 01.nr.09-39-1117/2021 i datës 23.07.2021, njoftimi nga e paditura i datës 05.08.2021, fletë dërgesa e datës 12.08.2021, vendim i datës 30.07.2021.

Pas vlerësimi të gjitha provave një nga një dhe të gjitha së bashku, konform nenit 8 të LPK-së, gjykata erdhi në përfundimin dhe vlerësimin se kërkesëpadija e paditëses në tërësi e pa bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara dhe deklaratimet e palëve në seanca gjyqësore, Gjykatës i rezulton se në mes të palëve nuk është kontestuese fakti se paditësi ka qenë në marrëdhënie të punës me të paditurën, në pozitën Higjienist.

Fakt kontestues në mes të palëve rezulton të jetë nëse paditësit i është krijuar baza ligjore për pagesën e diferencës së pagave dhe atë diferencën në mes të pagave që paditësi do ti kishte

realizuar tek e paditura dhe pagave që i njëjti i ka realizuar tek punëdhënësi tjetër për periudhën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga Kontrata e punës e datës 26.12.2020 vërtetohet fakti se paditësi kishte nënshkruar Kontratë të punës me afat të caktuar dhe atë nga data 26.12.2020 deri me datë 31.06.2021.

Nga kërkesa e datës 06.05.2021 vërtetohet fakti se paditësi kishte paraqitur ankesë tek e paditura përmes të cilës kishte kërkuar që ti paguhej gjysma e pagës për muajin mars 2021, dhe pagat e plota për muajit prill dhe maj të vitit 2021.

Nga dëshmitë e pagave: pagesa për muajin 03 dhe 04, pagesa për muajin 04/21, pagesa për muajin 05/21, pagesa për muajin 06/21, pagesa për muajin 07/21, vërtetohet fakti se paditura i kishte paguar paditësit pagat për muajt, Mars, Prill, Maj, Qershor dhe Korrik të vitit 2021.

Nga vërejtja e datës 13.09. 2019 dhe vërejtja e datës 26.01.2021 vërtetohet se e paditura paditësit i kishte shqiptuar dy herë vërejtje, dhe atë që të dyja me arsyetimin për shkak të mos respektim të punës, sjellje jo të mira dhe mos përfilljeve të kërkesave dhe urdhrave të menaxhmentit.

Nga vendim i datës 30.07.2021 vërtetohet fakti se e paditura përmes këtij vendimi, paditësit i kishte ndërprerë Kontratën e Punës, ma arsyetimin për shkak të sjelljes jo të mirë ndaj menaxhmentit si dhe mos përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësisive të punës. Në arsyetim të këtij vendimi theksohet se paditësit me datë 13.09.2019 i ishte shqiptuar vërejtja e parë me shkrim dhe se me datë 26.01.2021 e paditura ka marr vendim për ndërrimin të vendit të punës nga QMF nr.6 në QMF nr.4pa ju ndryshuar paga, po i njëjti nuk ka pranuar, si dhe po ashtu arsyetohet se me datë 26.01.2021 paditësi është paralajmëruar se mos zbatimi i shkresës në fjalë do të sjell deri në ndërprerjen e Kontratës së punës.

Nga raport zyrtar i inspektoratit të punës me numër 01.nr.09-39-1117/2021 i datës 21.07.2021 vërtetohet fakti se inspektorati i punës kishte realizuar inspektim tek e paditura duke marr shkas nga ankesa e paditësit në këtë institucion, me ç ‘rast inspektorati i punës në raportin në fjalë kishte konstatuar se e paditura kishte bërë shkelje të dispozitës së nenit 10 të Ligjit të Punës ngase nuk i ka ofruar kontratën e punës paditësit, se e paditura kishte bërë shkelje të dispozitës së nenit 55 ngase nuk i ka paguar pagat paditësit nga muaji shkurt i vitit 2021, se kishte shkelur neni 71 të Ligjit të Punës ngase nuk e ka njoftuar paditësin 30 ditë më herët për mos vazhdimin e Kontratës së punës, dhe nenin 72 për mos dhënien e vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Nga vendimi me numër 01.nr.09-39-1117/2021 i datës 23.07.2021 i inspektoratit të punës, vërtetohet fakti se ky institucion e kishte gjetur të bazuar ankesën e paditësit sepse e paditura kishte bërë shkelje të nenit 10, nenit 7, 55, 71 dhe 72 të Ligjit të Punës.

Bazuar në vërtetimin e gjendjes faktike, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit, e tillë siç e njëjta është kërkuar nga paditësi është në tërësi e pabazuar. Gjykata fillimisht thekson

faktin se, paditësi me padinë fillestare të paraqitur në këtë gjykatë me datë 07.07.2021 kishte kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguajë pagat e papaguara nga data 15.02.2021 e tutje. Ndërsa me precizimin e padisë pas nxjerrjes së ekspertizës financiare, paditësi ka kërkuar që të detyrohet e paditura që të njëjtit t'ia paguajë diferencën mes pagave që paditësi do të realizonte tek e paditura dhe pagave që paditësi i ka realizuar tek punëdhënësi tjetër, dhe atë për periudhën nga data 01.08.2021 deri me datë 21.02.2023 (dita kur paditësi është pensionuar).

Thënë këtë, ndonëse paditësi gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka pretenduar kundërligjshmërinë e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës i datës 30.07.2021, gjykata sa i përket këtij pretendimi vlerëson se paditësi me rastin e inicimit të kësaj procedure, gjegjësisht kërkimit të mbrojtjes gjyqësore lidhur me të drejtat e pretenduara, nuk e ka kontestuar ligjshmërinë e këtij vendimi në asnjë fazë të kësaj procedure, gjegjësisht as me padinë fillestare e as në precizimin e saj të bërë në seancën e datës 23.07.2024, nuk ka kërkuar vërtetimin e kundërligjshmërisë së këtij vendimi. Dispozita nga neni 79 e Ligjit të Punës përcakton decidivisht që: *"Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të iniciojë kontest pune në Gjykatën Kompetente"*. Mbi këtë bazë, përderisa statusi i paditësit në kuadër të marrëdhënies së punës është përcaktuar në bazë të një vendimi të palës së paditur, i cili është ende në fuqi dhe ka prodhuar efekte juridike, rrjedh se paditësi nuk e ka krijuar bazën e mjaftueshme për të realizuar të drejtën e pretenduar - kërkesën për pagesën e diferencës së pagave nga data 01.08.2021 deri me datë 21.02.2023. Për më tepër, gjykata sjell në vëmendje se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës mban datën 30.07.2021 ndërsa paditësi padinë në këtë gjykatë e ka paraqitur me datë 07.07.2021, pra para nxjerrjes së vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Përkundër kësaj, nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, gjykata gjen se paditësi kishte nënshkruar Kontratë të punës për periudhën kohore nga data 26.12.2020 deri me datë 31.06.2021, çka rezulton se afati i vlefshmërisë së Kontratës së punës mes paditësit dhe të paditurës ka skaduar me datë 31.06.2021. Ndërsa nga dëshmitë e pagesave të administruara si prova dhe të cituara më lartë në arsyetim të këtij aktgjykimi, vërtetohet fakti se e paditura i kishte paguar pagat paditësit për muajt mars, prill, maj dhe qershor të vitit 2021, e po ashtu i kishte paguar paditësit pagën edhe për muajin korrik 2021 për shkak të mos njoftimit tridhjetë ditë më herët për mos vazhdimin e Kontratës së punës.

Rrjedhimisht, sipas vlerësimit të kësaj gjykate, siç theksuar më lartë paditësi përmes petitumit të padisë nuk ka kërkuar anulimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, por në cilëndo situatë edhe sikur të vërtetohej kundërligjshmëria e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, paditësit nuk mund ti takojnë të drejta jashtë kohëzgjatjes së Kontratës së punës, andaj meqenëse e paditura i ka paguar pagat paditësit deri në momentin e skadimit të afatit të vlefshmërisë së Kontratës së punës, rezulton se kërkesa e paditësit që të detyrohet e paditura që të paguajë diferencën e pagave për periudhën 01.08.2021 deri me datë 21.02.2023 (periudhë kjo pas skadimit të afatit të Kontratës) është e pa bazuar.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 452 par.1, 454 par.1 lidhur me nenin 463 par.1 LPK-së, duke e obliguar paditësin si palë që ka humbur kontestin gjyqësor që të paditurës t'ia kompensojë shumën e tërësishme të shpenzimeve të nevojshme të procedurës kontestimore në vlerë të përgjithshme prej 374.00 euro, sipas kërkesës së specifikuar dhe atë: 104.00 Euro në emër të përpilimit të përgjigjes në padi, për përfaqësim në dy seanca gjyqësore, secila në shumën prej 135,00 euro. Sa i përket lartësisë së shpenzimeve të aprovuara, Gjykata iu referua Rregullores për Tarifat e Avokatëve, numrave tarifor 6 dhe 7.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, bazuar në nenin 160 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-**

**Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.5286/2021, datë 13.08.2024.**

Gjyqtari  
Florian Krasniqi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.